



QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT


SHKURT




21 SHKURTI – DITA NDËRKOMBËTARE E GJUHËS AMTARE



13 SHKURT 2025 / TAKIM ME PËRFAQËSUES TË AMBASADËS GJERMANE DHE JAPONEZE NË TIRANË DHE ME AMBASADORIN E BE-së, ME NË FOKUS PUBLIKIMIN E LIBRIT SHQIP NË GJUHË TË TJERA



4 SHKURT 2025 / SHPALLET ZYRTARISHT VITI 2025 “VITI MAKS VELO”




Viti i Maks Velo

4 shkurt 2025, ora 11:00
Muzeu Kombëtar i Përgjimeve
Shtëpia me Gjethe



“TRASHËGIMIA LETRARE E DRITËRO AGOLLIT”



FONDI I KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ –



“FOTOGRAFIA QË PREK INDET E QYTETIT” - Fotoalbum i fotografit Griseld Hoxha



GRANIT ZELA – Bisedë për romanin e tij “PËRMBYTJA”





QKLL 2025

SHKURT



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

21 SHKURTI – DITA NDËRKOMBËTARE E GJUHËS AMTARE



Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare është një ditë ndërkombëtare e shpallur nga UNESCO në vitin 1999. Si e tillë ajo festohet më 21 shkurt të çdo viti. Qëllimi i caktimit të saj është promovimi dhe ndërgjegjësimi për diversitetin gjuhësor dhe kulturor si dhe promovimin e shumëgjuhësisë. Dokumenti 16/C i UNESCO-s nga viti 1970 thotë: "Gjuha amtare shënon rrugën e qenies njerëzore dhe përmes saj ajo hyn në shoqëri, bën kulturën e grupit, të cilit i takon dhe vendos bazat për zhvillimin e aftësive intelektuale të saj." Një ditë

nderimi për gjuhën e bukur shqipe.

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizoi një simpozium në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, me pjesëmarrjen e shumë gjuhëtarëve, pedagogëve e studiuesve të njohur.

Profesoreshë Mimoza Kore referoi mbi autoktoninë e popullit shqiptar në trojet aktuale dhe faktet gjuhësore që e mbështesin atë, ndërsa profesoreshë Anila Omari mbajti referatin "Sa e vjetër është shqipja dhe si ka ndryshuar ajo". Shqipja është një gjuhë rreth 6-mijëvjeçare, e shkëputur nga blloku indoevropian që ka pësuar ndryshime të mëdha ndër vite, u tha nga gjuhëtarët.

Nga studiuesit u tha se duhet punë për të ruajtur autoktoninë e shqipes dhe përgjigjen ndaj teorive sllave, që e cenon atë. Në aktivitet u fol edhe për "përkujdesjen e organizuar shtetërore e shoqërore, ndaj shqipes" nga Prof. dr. Emil Lafe, i cili dha këshilla për disiplinimin e gjuhës dhe ruajtjen

e identitetit të saj, përmes pasurimit të leksikut dhe njehsimit të terminologjisë. "Ndërgjegjësimi për vlerat e shqipes" titullohej referati i Prof. dr. Xhevat Lloshit, që shpjegoi lidhjet mes ndërgjegjes dhe gjuhës. Sipas tij, ne bëhemi njerëz vetëm prej të folurit dhe ndërgjegjes, ndaj jemi shqiptarë se flasim shqip.

Prof. dr. Mimoza Gjokutaj foli rreth sfidave të gjuhës amtare në lidhje me globalizmin, apo teknologjinë, përballë realitetit shumëgjuhësh për ta gjallëruar atë. Profesoreshë Linda Meniku u përqendrua te shqipja e diasporës përballë realitetit të shumëgjuhësisë. Studimet janë të mangëta, edhe statistikisht, ndërsa shtohet nevoja e mësimin të shqipes ngado në botë. Profesoreshë Anila Mullahi theksoi rëndësinë e letërsisë për zhvillimin e gjuhës, për mësimin e saj. Për të, shkrimtarët e ruajnë dhe pasurojnë gjuhën amtare, ndaj tekstet e tyre duhen studiuar më thellësisht në tekstet mësimore.





QKLL 2025

SHKURT



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

1 SHKURT 2025 / FONDI I KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ - THIRRJE PËR APLIKIM



THIRRJE
PER
APLIKIM:
“Fondi i
Krijimtarisë
Letrare për
të Rinj”
Jeni autor i
ri, dhe keni
ende në
dorëshkrime
krijimet
tuaja të
para! Kjo
thirrje është
një mundësi
për t'i sjellë
ato në një

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Thirrja u drejtohet lëvruesve të poezisë dhe prozës nga mosha 18 deri 35 vjeç. Aplikimi kryhet nga një botues i pajisur me licencë përkatëse, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Shuma e financimit për mbështetjen e procesit krijues të veprës, do t'i paguhet drejtpërdrejt botuesit. Aplikimi fillon më datë 01.02.2025 dhe përfundon më datë 01.03.2025, ora 16:00.


Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim për fazën përzgjedhëse. Aplikimet do të dorëzohen në formë të printuar, dorazi ose në rrugë postare, në zyrën e Protokollit të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit brenda datës 01.03.2025, ora 16:00, në adresën elektronike: info@qkll.gov.al dhe atë postare: Rruga “Papa Gjon Pali II”, nr. 1010, Tiranë, Shqipëri.

libër.

Nëpërmjet këtij fondi, QKLL-ja synon të promovojë letërsinë e re shqipe, duke iu ardhur në ndihmë autorëve të rinj shqiptarë për të botuar dhe për t'u bërë pjesë e një hapësire më të gjerë njohjeje përballë lexuesit.

Për informacione të mëtejshme, mos ngurroni të na shkruani në: info@qkll.gov.al

4 SHKURT 2025 / SHPALLET ZYRTARISHT VITI 2025 “VITI MAKS VELO”



Qendra
Kombëtare
e Librit dhe
Leximit në
bashkëpun
im me
Bibliotekën
Kombëtare

nder të figurës së intelektualit të shquar Maks Velo ku edhe u shpall zyrtarisht viti 2025 si “Viti Maks Velo”.

Të pranishëm në aktivitetet ishin njohës dhe dashamirës të veprimtarisë së Maks Velos.

Aktiviteti u zhvillua në mjediset e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”. Në këtë ceremoni rasti u vlerësua figura e shumanshme e Maks Velos, angazhimi e kontributi i tij në

letërsi, pikturë, arkitekturë dhe shoqëri, si aktivist i shquar.

Me iniciativën e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, mbështetur nga Autoriteti i Dosjeve, Biblioteka Kombëtare dhe “Shtëpia me Gjethe”, këto institucione që nënshkruan edhe marrëveshjen e rastit, për organizimin e aktiviteteve të ndryshme për Maks Velo, në 90-vjetorin e lindjes dhe 5-vjetorin e ndarjes nga jeta.

të Shqipërisë, Autoritetin për Informim për Dokumentet e Sigurimit të Shtetit dhe Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” zhvilloi aktivitetin përkujtimor që u organizua në






QKLL 2025

SHKURT



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



13 SHKURT 2025 / TAKIM ME PËRFAQËSUES TË AMBASADËS GJERMANE DHE JAPONEZE NË TIRANË DHE ME AMBASADORIN E BE-së, ME NË FOKUS PUBLIKIMIN E LIBRIT SHQIP NË GJUHË TË TJERA

Përkthimi i librit shqip në gjuhë e kultura të tjera ishte në fokus të takimit me Sekretarin e Parë dhe drejtuesin e zyrës së Kulturës dhe Shtypit në ambasadën gjermane në Tiranë, z. Jan Maibom dhe Sekretarin e parë dhe Përgjegjës për Kulturën, në ambasadën

japoneze në vendin tonë, Z. Kohei Tsuboi.

Takimi nxori në pah vështirësitë e publikimeve nga letërsia origjinale japoneze, si pasojë e mungesës së përkthyesve nga kjo gjuhë. U vu në dukje se Fondacioni Japonez me seli në Romë, mund të jetë një

mbështetës i mirë i botimeve shqiptare të letërsisë dhe autorëve japonezë. Ambasada u shpreh e gatshme të organizojë e mbështesë Qendrën në aktivitete që lidhen me letërsinë, por edhe me artin japonez.

14 SHKURT 2025 / ZGJIDHET JURIA QË DO TË GJYKOJË VEPRAT MË TË MIRA TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ - THIRRJE PËR APLIKIM

Shkrimtari Ylljet Aliçka, profesorja dhe kritikja e letërsisë Dhurata Shehri, gazetarja Arta Marku do të jenë anëtarë të jurisë për Fondin e Krijimtarisë Letrare për të Rinj.

Ftojme të gjithë krijuesit e rinj që kanë një vepër në dorëshkrim të aplikojnë në këtë fond, deri më 1 mars 2025.





QKLL 2025

SHKURT




AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

18 SHKURT 2025 / TAKIM ME TEMË “TRASHËGIMIA LETRARE E DRITËRO AGOLLIT”


“Trashëgimia letrare e Dritëro Agollit” ishte aktiviteti i organizuar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, me pjesëmarrjen e studiuesve dhe lexuesve të shkrimtarit të madh. Nga të pranishmit u analizua figura e Dritëroit në shumë dimensione. Analiza e profesor Behar Gjokës u përqendrua te proza e Agollit, veçanërisht te “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top”. Sipas tij, satira te “shoku Zylo” ishte rebelim ndaj kohës, ndërsa “Njeriu me top” e quajti analizë sociale të fshatit, zakoneve të tij, të marrëdhënieve të njeriut me pronën, vatrën familjare etj. Studiuesja Rovena Vata foli për poezinë e Dritëro Agollit, larminë e saj, duke veçuar shpirtin e tij lirik që mbizotëron në të gjithë krijimtarinë e tij.

Pedagogia Anila Mullahi vlerësoi rëndësinë e krijimtarisë së Agollit, pas viteve '90, që është pak e analizuar, ndonëse është e konsiderueshme nga pikëpamja sasiore. Madje, ka vepra si “Arka e djallit” që sipas saj, mund të quhen fare mirë, kryevepra.

Të pranishmit vlerësuan mbajtjen e aktiviteteve të tilla, si nevojë për të nxjerrë më mirë në pah për lexuesin vlerat artistike të Dritëro Agollit, edhe pse për të është folur mjaft.



22 SHKURT 2025 / “FOTOGRAFIA QË PREK INDET E QYTETIT” - FOTOALBUM I FOTOGRAFIT TË RI GRISELD HOXHA



U promovua në mjediset e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit foto albumi “Fotografia që prek indet e qytetit” nga fotografi i ri Griseld Hoxha.

Një foto album me një rrëfim ngjarjesh për qytetin e Durrësit ku qenë të pranishëm prof. Ardian Isufi, fotografi Roland Tasho dhe redaktorja e foto albumit Arjola Kondakçiu, të cilët folën për artin e fotografisë dhe punën artistike të Griseld Hoxhës.

26 SHKURT 2025 / ME SHKRIMTARIN GRANIT ZELA – BISEDË PËR ROMANIN E TIJ “PËRMBYTJA”

“Përmbytja” është romani më i fundit i shkrimtarit Granit Zela, botuar nga shtëpia botuese “Onufri”.

Në një bisedë me profesoreshë Elsa Skënderi Rakiplari, autori foli mbi procesin e krijimit të romanit, si dhe u vu përballë disa interpretimeve mbi romanin e tij nga të pranishmit, të cilët njëkohësisht shprehën vlerësimet e tyre mbi narrativën dhe simbolikat që ndërtohen brenda tekstit (romanit).

“Secili qytet ka fatin e tij, biografinë e tij. Çdo qytet meriton një libër të mirë për të. Pyetja është: Si ta shkruajmë?”



QKLL 2025

SHKURT




AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

Pikërisht kësaj pyetjeje i përgjigjet theksin e vet metafizik të legjendave, fantazmagorike, trillet e marrëzishme urbane midis qytetit të shenjtë (Babilonit). Kuptohet që theksi vihet (ose kohë-hapësinor) të qytetit si të, si me të vetmin diell dhe pikë tij - gjymtyrët e tij organike e fatidike.”



romani “Përmbytja” i Granit Zelës me besëtytnive, krijesave fantastike e - elemente dikotomike të mitologjive (Jerusalemit) dhe qytetit të përdalë mbi unitetin e përshqyer trup-e-shpirt Qenie dhe se të gjitha llogaritë bëhen me shkrirjeje drejt të cilit gjakojnë njerëzit e - Agron Tufa



3 SHKURT 2025 / EDICIONI I 54-T I KONKURISIT NDËRKOMBËTAR TË LETËRSHKRIMIT PËR TË RINJTË “IMAGJINONI SE JENI OQEANI”. Shkruani një letër dikujt duke i shpjeguar pse dhe si duhet të kujdeset mirë për ju



Universal Postal Union (një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara me seli në Bernë, Zvicër) rikthen edicionin e 54-t të Konkursit Ndërkombëtar të Letërshkrimit për të Rinjtë, në partneritet me Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO) dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO).

Në kontekstin e Konferencës së Oqeanit të OKB-së 2025 që do të zhvillohet

në qershor, tema e këtij viti është: “Imagjinoni se jeni oqeani”. Shkruani një letër dikujt duke i shpjeguar pse dhe si duhet të kujdeset mirë për ju.

Kompeticioni Ndërkombëtar i Letërshkrimit synon përmirësimin e letraritetit përmes artit të të shkruarit. Fëmijët dhe të rinjtë (mosha 9-15 vjeç) janë target-grupi i përzgjedhur. Ju ftojme ta shihni si një mundësi për të gjithë ju që shkruani.

Kompeticioni kërkon të inkurajojë pjesëmarrësit që të shprehin kreativitetin dhe aftësitë e tyre gjuhësore.

Universal Postal Union (UPU) nuk pranon shkrime, të cilët dërgohen nga shkollat apo individët. Të interesuarit që duan të



QKLL 2025

SHKURT



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

jenë pjesëmarrës duhet të kontaktojnë Operatorin Kombëtar Postar ose organizatën, e cila merret me këtë kompeticion.

Afati i dorëzimit të shkrimeve është deri më 5 maj 2025.

Për më shumë info shkruaj në: info@qkll.gov.al

8 SHKURT 2025 / PËRURIMI I LIBRIT PËR FËMIJË "ANTOKU" I AUTORIT RALF SPIRO

"Antoku" quhet libri për fëmijë i autorit Ralf Spiro, i cili u përurua në sallën e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit. Aktiviteti ishte konceptuar si një bisedë mes poeteshës Mimoza Ahmeti dhe autorit, i cili iu përgjigj pyetjeve dhe interesimit për krijimin e tij. Ngjarja në këtë tregim bazohet në historinë dhe mitologjinë japoneze aty ku mbështetet mirëfilli dhe kultura e

Japonisë, që ka në qendër të saj familjen. Protagonisti, Antoku është përcjellës i diturisë, për të larguar errësirën, jo vetëm simbolikisht. Vepra është trajtuar në formën e përrallës, pasi u drejtohet fëmijëve, të cilëve u nevojitet një gjuhë e thjeshtë për të nxënë dije.

Ralf Prifti sqaroi se ka projekte të tjera, veçanërisht për fëmijë, dhe në shumicë inspironet nga djali i tij.

Autori sqaroi se ka testuar gjuhën e librit tek i biri për të arritur thithjen e materialit, që gjithnjë është bazuar te fantazia. Sipas tij, Antoku është përzgjedhur për të qenë personazh kryesor, pasi është i vetmi perandor fëmijë që ka ekzistuar realisht në Japoni.

